



UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA"
FAKULTETI AGROBIZNESIT

Shërbimet dhe lehtësitë e disponueshme për studentët & Opsionet e bursave

Fakulteti i Agrobiznesit dhe Universiteti "Haxhi Zeka" sigurojnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe lehtësish për mbështetjen e studentëve, duke marrë parasysh nevojat e një popullate të larmishme studentësh

Shërbimet akademike dhe këshilluese:

Shërbimi / Lehtësia	Përshkrimi	Njësia përgjegjëse
Këshillimi akademik (sistemi tutorial)	Profesorët dhe asistentët e Fakultetit të Agrobiznesit mbajnë orar konsultimesh dhe tutorati për studentët, për të ndihmuar në kuptimin e lëndëve, planifikimin e studimeve dhe tejkalimin e vështirësive.	Fakulteti i Agrobiznesit, Koordinator i Cilësisë
Orari i konsultimeve	Çdo mësimdhënës publikon orarin e konsultimeve zyrtare, ku studentët mund të paraqesin pyetje akademike dhe të marrin udhëzime individuale.	Stafi akademik, Fakulteti
Sistemi SEMS	Sistemi elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS) përdoret për regjistrimin e notave, evidencën e përparimit të studentëve, pyetësorët për cilësinë dhe raportet statistike.	Zyra për Çështje Mësimore, Zyra e Cilësisë
Kalendar Akademik	Kalendar i publikuar që përcakton qartë semestrat, afatet e provimeve, afatet e regjistrimit dhe periudhat e mobilitetit.	Rektorati, Fakulteti

Shërbimet administrative dhe informuese:

Shërbimi / Lehtësia	Përshkrimi	Njësia përgjegjëse
Java e Mirëseardhjes	Organizuar për studentët e rinj, ku ata informohen për rregulloret e studimit, ambientin universitar, shërbimet dhe procedurat kryesore administrative.	Rektorati, Fakulteti i Agrobiznesit, Zyra për Çështje Studentore
Zyra për Shërbim të Studentëve	Ofron informacione për regjistrimin, certifikata, transkripta, lëshim dokumentesh dhe çështje tjera studimore.	Fakulteti i Agrobiznesit
Informimi në uebfaqe	Të gjitha rregulloret kryesore, konkursi i pranimit, formularët, njoftimet dhe udhëzimet publikohen në faqen zyrtare të universitetit dhe faqen e Fakultetit të Agrobiznesit.	Rektorati, Zyra për Marrëdhënie me Publikun
Zyra Ligjore dhe procedurat e ankesave	Ofron informata për procedurat e ankesave dhe apeli meve; ankesat trajtohen fillimisht në fakultet, pastaj në nivel të rektoratit dhe senatit, sipas rregulloreve në fuqi.	Fakulteti, Rektorati, Komisionet për Ankesa

Shërbimet për zhvillim karriere dhe mobilitet:

Shërbimi / Lehtësia	Përshkrimi	Njësia përgjegjëse
Qendra për Zhvillim të Karrierës	Ofron këshillim për karrierë, trajnime për aftësi të buta, informim mbi praktikat profesionale dhe mundësitë e punësimit pas studimeve.	Qendra për Zhvillim të Karrierës, Fakulteti
Programet e mobilitetit ndërkombëtar	Studentët informohen dhe mbështeten për pjesëmarrje në programe mobiliteti, përmes sesioneve informuese, udhëzimeve dhe asistencës në aplikim.	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Njohja e krediteve ECTS	Kreditet e fituara në institucione të tjera njihen sipas udhëzimeve dhe rregulloreve për ECTS (1 ECTS = 25 orë angazhim), në përputhje me Manualin e Akreditimit dhe aktet e brendshme.	Rektorati, Komisionet e Studimeve, Fakulteti
Informimi për mobilitetin	Universiteti publikon të dhëna për numrin e studentëve që kanë marrë pjesë në mobilitet ndërkombëtar dhe të arriturat.	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Infrastrukturë akademike dhe teknike:

Lehtësia	Përshkrimi	Njësia përgjegjëse
Laboratorë mësimorë	Fakulteti i Agrobiznesit ofron laboratorë për teknologji ushqimore, prodhim bimor dhe ekologji të aplikuar, të pajisur për ushtrime praktike dhe kërkime bazë.	Fakulteti i Agrobiznesit
Biblioteka Qendrore dhe bibliotekat e njësive	Ofron literaturë shkencore, tekste bazë, revista dhe qasje në burime elektronike për studentët dhe stafin.	Biblioteka Qendrore Universitare,
Pajisje IT dhe platforma digjitale	Studentëve u sigurohet qasje në laboratorë kompjuterikë, internet, si dhe platforma digjitale për mësim dhe komunikim elektronik.	Zyra e TI-së, Fakulteti
Hapësira studimi	Sallat e ligjëratave, sallat e seminareve dhe hapësirat e posaçme janë në dispozicion për mësim, ushtrime dhe aktivitete akademike.	Fakulteti i Agrobiznesit

Aktivitetet jashtëshkollore dhe mbështetja sociale:

Shërbimi / Lehtësia	Përshkrimi	Njësia përgjegjëse
Universiteti veror dhe dimëror	Organizohen aktivitete akademike dhe kërkimore me pjesëmarrje të studentëve vendor dhe ndërkombëtar, duke mundësuar shkëmbim përvojash dhe kontakte profesionale.	Rektorati, Fakultetet
Aktivitete sportive dhe rekreative	Universiteti vë në dispozicion hapësira për sport dhe rekreacion, si dhe mbështet nisma studentore në sport e aktivitete fizike.	Rektorati, Zyra për Çështje Studentore
Aktivitete kulturore dhe vullnetare	Inkurajohet pjesëmarrja e studentëve në aktivitete kulturore, debate, punëtori dhe nisma vullnetare brenda dhe jashtë universitetit.	Fakulteti, organizatat studentore
Mbështetje për studentët nga grupe të cënueshme	Universiteti dhe fakulteti i kushtojnë vëmendje të veçantë studentëve nga grupe të nën-përfaqësuar dhe atyre me nevoja të veçanta, duke ofruar mbështetje shtesë në organizimin e studimeve dhe qasjen në shërbime.	Zyra për Çështje Studentore, Zyra për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore

Opsionet e bursave:

Kategoria e bursës	Lloji i bursës	Përshkrimi	Kujt i ofrohet	Institucioni përgjegjës
Bursa nga Universiteti “Haxhi Zeka”	Bursa e ekselencës	Bursë vjetore për studentët me rezultate të larta akademike.	Studentët më të dalluar në Bachelor/Master.	UHZ – Rektorati & Fakulteti
Bursa nga Ministria e Arsimit (MASHTI)	Bursa e ekselencës kombëtare	Bursë për studentët me sukses të jashtëzakonshëm në nivel vendi.	Studentë me mesatare të lartë.	MASHTI
	Bursat për vajza në STEM	Mbështetje për ritjen e pjesëmarrjes së vajzave në fusha shkencore/teknike.	Studentet femra në programe STEM (p.sh. Teknologjia Ushqimore, Ekologjia).	MASHTI
Bursa nga Komuna	Bursa komunale për ekselencë	Bursë për studentët me rezultate të larta akademike nga komuna e tyre.	Studentë me banim në komunën përkatëse.	Komunat e Kosovës
Bursa nga sektori privat	Bursa të kompanive të agrobiznesit	Ofruar nga kompani private të sektorit ushqimor dhe bujqësor.	Studentë me performancë të mirë dhe interes për praktika.	Biznese private & Fakulteti
	Sponsorizime kërkimore	Mbështetje për projekte kërkimore, inovacion ose punë laboratorike.	Studentë të angazhuar në projekte kërkimore.	Kompanitë private
	Bursa për praktika profesionale	Mbështetje financiare gjatë realizimit të praktikave profesionale.	Studentë të programeve të Fakultetit të Agrobiznesit.	Biznese private & QZHK